

---

## **Prioritetet në bashkëpunimin dhe kooperimin ndërkombëtar bazuar në Planin Strategjik 2015-2020**

---

Universiteti European i Tiranës ka ndërtuar Planin Strategjik 2015-2020, i cili parashton, ndër të tjera, edhe këto prioritetet për bashkëpunimin dhe kooperimin ndërkombëtar.

Duke u nisur nga vizioni që:

- UET të bëhet një lider në sistemin universitar shqiptar duke realizuar në cilësi të lartë e standarte ndërkombëtare tre nga detyrat kryesore të arsimit të lartë: prodhimi i dijes dhe njohurive shkencore/akademike; transmetimi sa më i plotë e cilësor i tyre tek studentët; stokimi dhe grumbullimi i dijeve, njohurive e informacioneve bazike në bibliotekë dhe qendra analoge informacioni dhe krijimi i aksesit për studentët dhe pedagogët.
- UET të jetë një aktor i rëndësishëm dhe institucion lider në kontributin e tij për zhvillimin social-ekonomik të vendit, duke prodhuar “produkte” sa më cilësore në shërbim të shoqërisë, ekonomisë, politikës dhe zhvillimit të qëndrueshëm afat-gjatë.
- UET të jetë pjesë e rrjeteve dhe projekteve të bashkëpunimit universitar, shkencor e akademik me universitetet në BE, OECD, etj., si dhe të kontribuojë në lidhje më të gjera e specifike me universitetet e rajonit të Europës jug-lindore, vecanërisht ato të hapësirës shqiptare në Kosovë e Maqedoni.

### **Prioritetet në bashkëpunimin dhe kooperimin ndërkombëtar 2015-2020 janë:**

- UET synon të bëhet një qendër e rëndësishme dhe pikë referimi kombëtare e rajonale në kooperimin akademik universitar, kërkimin shkencor, aktivitetin botues, dhe promovimin e vlerave zhvilluese e qytetare të arsimit të lartë.
- UET synon që të jetë pjesë integrale e rrjeteve dhe strukturave të organizuara institucionale universitare në kuadrin e rajonit të Europës jug-lindore, vendeve të bashkimit European dhe më gjerë vendeve anëtare të OCDE-së.
- UET synon organizimin dhe ofrimin e diplomave të përbashkëta me universitetet partnere në kuadrin e disa programeve të caktuara studimesh me interes të përbashkët.

- UET synon përfshirjen në sa më shumë projekte zhvilluese akademike e shkencore në kuadrin e projekteve europiane të arsimit të lartë, projekte që mbi të gjitha targetojnë zhvillimin e stafit akademik, mobilitetin e pedagogëve dhe studentëve, aplikimin e standarteve europiane të cilësisë, organizimin e konferencave shkencore të përbashkëta, përkthime e botime akademike e pedagogjike nga autorë të njohur ndërkombëtarisht, pajisjen e mjediseve mësimore dhe laboratoreve, etj.
- UET mbështet fuqimisht Zyrën për Zhvillimin e Projekteve dhe Partneriteteve si një njësi e integruar në strukturat e universitetit, e përfshirë në projekte dhe Programe që targetojnë fushat e ekspertizës si: shkenca sociale dhe edukim, drejtësi, ekonomi dhe teknologji e informacionit. Kjo njësi prodhon projekte dhe kërkim të orientuar ndaj politikave dhe aktiviteteve për zhvillimin e stafit akademik e administrativ si dhe studentët në të treja ciklet e studimit. Zyra për Zhvillimin e Projekteve dhe Partneriteteve thëllon vazhdimisht eksperiencën e saj në hartimin dhe zbatimin e projekteve me partnerë dhe donatorë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
- Fokusi i punës së Zyrës për Zhvillimin e Projekteve dhe Partneriteteve për 5 vitet e ardhshme orientohet kryesisht drejt programeve të Bashkimit European për Kërkim dhe Zhvillim si: Horizon 2020; Erasmus +; European Programme for Science and Technology (COST); Rrjeti Euraxess por edhe ndaj programe të tjera ndër/kombëtare për kërkim dhe zhvillim si Regional Research Promotion Programme (RRPP), One UN, the Fondacioni i Hapur për Shoqërinë në Shqipëri, Albanian Besa Capital (ABC), Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, etj.